REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 713-729/20
Datë/Datum. 28.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**19.10.2020**	**28.10.2020**	**Nr.713-729/20,**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.09.2020, OE "**Multi business Group**" ka parashtruar ankesë me nr.713/20 dhe me datën 29.09.2020 OE **"Nabs SHPK & Detas D.o.o"** ka parashtruar ankesë me nr.729/20, kundër njoftimit për **anulim** të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit"** me nr. prok. 622-20-2058-211, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Komuna e Prizrenit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **1.500.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Vendimi i OSHP-se Nr.776/19 dhe 73-80/20.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Multi business Group"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderit
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies së kontratës.
- Neni 62 i LPP-së – Përfundimi i aktivitetit te prokurimit.
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.
- Neni 44.5 i RRUOPP-së

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Te nderuar me datën 09.09.2020 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendi min e AK-se ku na ka shpallur si tenderues te eliminuar me arsyetimin se Certifikata ISO EN sipas kërkesës ne Aneks 1Specifikimet teknike te detyrueshme. Nuk janë paraqitur te gjitha certifikatat e kërkuara per produktet e ofertuar

2b. tij këtë i punësuar Se paku 10 punëtorë, me profile te ndryshme (Mungojnë diplomat për një pjese te stafit), ndërsa e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit me arsyetimin se nuk keni pranuar oferta te përgjegjshme.

Arsyeja e pare e AK -se per eliminimin tone nuk qëndron për faktin se ne e plotësojmë këtë kërkesë dhe kemi

ofertuar konforrn kërkesave te FDT-se dhe te njoftimit për kontrate. Ne lidhje me arsyen e AK-se për eliminimin tone ju sqarojmë se ne dosje te tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qene *"Certifikata IST() EN sipas kërkesës ne Aneks 1 Specifikimet teknike te detyrueshme, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhuesi, autorizimi duhet te përmbajë - emrin e operatorit ekonomik , - Emri i projektit ne te cilin oferton - numri i prokurimit ,b, Katalogë për produktet e ofruara sipas aneksit j Specifikimet teknike te detyrueshme (ne pamundësi për te siguruar katalogët e kërkuara për shkak te situatës se kërkuar me pandemi, OE duhet te bej deklarate nen betim se me rastin e krijimit te kushteve, katalogët e kërkuara do ti sjelli: ashtu siç janë kërkuar*

Pra kërkesa e AK-se ka qene shume e qarte dhe ne konform kërkesës se FDT -se kemi ofertuar duke e bere deklaratën ashtu siç është parapare ku kemi deklaruar se katalogët do ti sjellim ashtu siç janë kërkuar ne momentin qe krijohen kushtet për katalogët.

Neve na janë krijuar kushtet për disa prej katalogëve te cilat i kemi prezantuar ne oferte, mirëpo për disa katalogë tjera nuk na janë krijuar ende mundësitë qe ti prezantojmë, Por ne Lidhje me këtë fakt ne përsëri keni bere deklaratën me te cilën kemi deklaruar se nuk na janë krijuar te gjitha kushtet edhe për katalogët tjera.

Andaj ky arsyetim i AK-sc për eliminimin tone nuk qëndron dhe është i pa bazuar sepse ne e kemi ofruar deklaratën konform kërkesës se FDT-se edhe pse i kemi ofruar disa nga katalogët pasi qe siç e cekem me larte nuk na jane ofruar kushtet per te prezantuar te gjithë katalogët, mirëpo ne për hir te korrektësisë j kemi ofruar katalogët për te cilat na janë krijuar kushtet ti dorëzojmë, ndërsa kemi ofruar deklaratën për katalogët tjera qe me rastin e krijimit te kushteve do ti sjellim edhe katalogët tjerë.

Sa i përket arsyes se dyte te AK-se per eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit ku e ka cekur se mungojnë diplomat për një pjese te stafit te punëtorëve, ju sqarojmë se gjate ofertimit ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jone ku janë bashkangjitur vetëm 7 nga 10 diploma sa janë kërkuar, mirëpo edhe pse ka ndodhur ky lëshim teknik AK-ja ka mundur te kërkoj sqarime shtese ne baze te dispozitave ligjore te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, pasi qe ne e kemi prezantuar listën e stafit mirëpo qe lëshimi teknik ka ndodhur tek diplomat. Pra nëse do tc kërkoheshin sqarime shtese ne do ti kishim ofruar AK-se edhe diplomat tjera, mirëpo AK-ja nuk i ka shfrytëzuar fare dispozitat e lartpërmendura duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht me i lire se te gjitha OE ofertues.

Ne me dt. 17.09.2020 kemi marre përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore per refuzimin e kërkesë tone për rishqyrtim. Arsyetimi i AK- se ne lidhje me refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim është i pa bazuar pasi qe faktet dhe dëshmitë tona i kemi shpjeguar shume qarte ne kërkesën tone per rishqyrtim, andaj ofe1'ta jone është konform kërkesave te FDT-se dhe te njoftimit për kontrate.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tone ne lidhje me diplomat e stafit te punëtorëve, veprim ky qe tregon qarte se ne e plotësojmë këtë kërkesë, sepse nëse nuk do ta plotësonim AK-ja do te kishte ofruar dëshmi se pse ne nuk e përmbushim kërkesën ne lidhje me diplomat e stafit te punëtorëve.
Pra duke u bazuar ne faktet e lartpërmendura shihet qarte se arsyetimi i AK-se është i pa bazuar dhe nuk qëndron pasi qe ne i përmbushim te gj itha kërkesat e FDT -se dhe te njoftimit për kontrate.

Duke u bazuar ne te gjitha sqarimet qe i kemi cekur me larte, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti te

prokurimit është bere ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 44.5 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara ne këto dispozita nuk janë përmbushur, për shkak se ne jemi ofertues i përgjegjshëm.
Duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur ta këtë ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-siç, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.
Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Multi Business Group" SH.P.K.ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per anulim te aktivitetit te prokurimit dhe lënda kthehet ne RIVLERESIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konforrn dispozitave te LPP-se.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente,

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Nabs SHPK & Detas D.o.o"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
- Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim/jo diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
- Neni 64 i LPP-së – Dëshmitë e kërkesave
- Neni 66 i LPP-së – Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Ne me date 09.09.2020 kemi pranuar njoftimin per tenderuesin e eliminuar dhe ne te njëjtën kohe njoftimin për anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit.
Ne letrën standarde te dërguar nga ana e AK, thuhet se j emi eliminuar sepse nuk e kemi plotësor vlerën e referencave.
Ak me këtë rast nuk e ka specifikuar fare se cilat referenca nuk i ka pranuar apo cilat referenca nuk e plotësojnë kërkesën e AK.
Ne në dosje te tenderit e kemi prezantuar një liste te referencave ku janë prezantuar projektet e realizuara nga partneri ne konorcium detas dleds i cili ne te njëjtën kohe është edhe prodhues i tyre.
Ne listën e prezantuar nuk e dijme se çka keni pas te pa qarte dhe se cila reference sipas AK nuk e plotësojnë kërkesën, pasi e ne letrën eliminuese nuk e keni përmendur se çka nuk kemi plotësuar.
Ne ne kërkesën për rishqyrtim, përsëri edhe një here ja kemi dërguar listën e referencave dhe referencat qe kane qene pjese e dosjes se tenderit.
Ne përgjigjen e tyre AK, nuk e ka kuptuar natyrën e projektit. Referencat janë për projektet ESCO, qe janë partneritete publiko private, me legjislacion te Bashkimit Evropian.

Ne referenca shume qarte shkruan se projektet janë kryer për qytetet Gottolengo, dhe Goffredo te komunës se MANTOVA,
Te dy referencat janë te vërtetuara nga inxhinieri mbikëqyrës ing. Renato Borrini i komunes se MANTOVA.
Nëse AK ka dyshuar ne vërtetësinë e referencave, i kane te gjitha kontaktet ne referenca dhe mund ti vërtetojnë duke i kontaktuar direkt komunën e Mantoves ne ITALI.
Ak nuk e ka kuptuar cka d.m.th. kontrata ESCO, Partneriteti Publiko Privat sipas legjislacionit te BE, për ndriçim publik, ne te cilin është nënshkruese e kontratës kompania DETAS. Dhe për është lëshuar edhe referenca.

Edhe njëherë po ju bashkëngjisim, listën e referencave dhe referencat qe janë dorëzuar me projekt. **LIST OF REFERENCES,** me katër referenca.
Kërkojmë nga organi shqyrtues i prokurimit qe ankesën tone ta .aprovoje si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivlerësim, pasi qe i plotësojmë te gjitha kërkesat e kërkuara ne dosje te tenderit dhe te njoftimit për kontrate

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.
-OE "Multi Bissnes Group" është eliminuar sepse nuk ka paraqitur certifikatat ISO EN te kërkesa specifikimet teknike te detyrueshme për produktet e ofruara. Dhe nuk ka paraqitur diplomat për një pjese te stafit te kërkuar ne dosje te tenderit.
- OE "Nabs SHPK & Detas D.o.o" i mungon kontratat e realizuara ne tri vitet e shkuara sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).
Komisioni konstaton se nuk ka asnjë tenderues te përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit dhe rekomandon anulimin e tije.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
OE ankues eshte pale e interesit ne kete aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
Ka psur vendim te me hershem per kete aktivitet te prokurimit. Vendimi i OSHP-se Nr.776/19 dhe 73-80/20. Megjitheate eshte aktivitet i publikuar rishtas ne vitin 2020.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshëm).
Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Multi business Group"

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejte ofertën e tyre, me arsyetimin se Certifikata ISO EN sipas kërkesës ne Specifikimet teknike te detyrueshme, nuk janë paraqitur te gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofertuar dhe mungojnë diplomat për një pjesë të stafit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit, respektivisht në FDT te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë kërkuara dhe ISO certifikatat për produktet e ofruara sipas specifikimit teknike te detyrueshëm.
Autoriteti kontraktues ne letrën standarde për eliminim qe i ka dërguar OE ankues i shkruan se nuk janë paraqitur te gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofruara. Ne këtë letër nuk përmenden konkretisht cilat certifikata mungojnë. Po ashtu ne këtë letër nuk përmenden konkretisht për cilin staf mungojnë diplomat qe jane kerkuar ne DT.
Meqenëse kjo kërkesë e dosjes se tenderit është ne kuadër te pikave dhe kërkesave qe parashihen ne nenin 69 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka mundet ti kërkoj operatorit ekonomik ankues për ti plotësuar këto dokumente bazuar në nenin 72 të LPP-së pika 2 që thotë:
"Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji"
Mirëpo autoriteti kontraktues nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi ligjore për plotësimin e dokumenteve te munguara te OE ankues, siç janë certifikatat ISO dhe diplomat e kualifikimit për stafin e prezantuar por apriori e ka bërë eliminimin e operatorit ekonomik ankues si tenderues i pa përgjegjshëm. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimi i OE ankues është i **bazuar**.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Nabs SHPK & Detas D.o.o"

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se mungojnë projektet e natyrës së kontratës të realizuara në tri vitet e shkuara dhe referencat për këto projekte të kërkuara sipas pikës 9.1&9.2 të FDT-së edhe pse ne me ofertë kemi bashkangjitur listën e projekteve dhe referencat për kryerjen e këtyre projekteve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne ofertën që operatori ekonomik ankues te ngarkuar ne platformën elektronik janë të bashkangjitur edhe disa referenca të cilat sipas listës janë të theksuar edhe në ankesën e dorëzuar në OSHP. Sqarimi i autoritetit kontraktues i dhënë ne vendimin e datës 17.09.2020 qe ka nxjerre si përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim nuk është i drejte. Ne ketë vendim theksohet se nuk janë pranuar referencat e partnerit të konzorciumit Detas Dleds të OE ankues sepse partneri në fjalë është prodhues i produkteve dhe referencat janë për furnizimet që i ka bërë për palët e treta dhe nuk janë referenca për punë të kryera.

Vetë aktiviteti i prokurimit të AK-së është kontratë për shërbim dhe jo kontratë për punë. Edhe kërkesa ne dosje ka qene për kontrata te natyrës se ngjashme. Referencat e ofruara janë për kontrata te kësaj natyre.
Për mendimin e ekspertit shqyrtues, referencat në fjalë e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Përveç këtyre referencave te dhëna ne ankese përmes një tabele, OE ankues ka dorëzuar edhe një prej referencave për një kontratë të ngjashme që ka pasur me vetë autoritetin kontraktues. Kërkesa e dosjes nuk e ka specifikuar sa referenca duhet të jenë. Në total lista e referencave të dorëzuara nga OE ankues për mendimin e ekspertit shqyrtues janë të pranueshme për këtë aktivitet të prokurimit sepse janë të natyrë së ngjashme. Mbi këtë bazë ky pretendim ankimor vlerësohet si **i bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues gjatë procesit te ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimittë ofertave në këtë aktivitet të prokurimit ka eliminuar si te pa përgjegjshëm operatorin ekonomik ankues "**Multi business Group**" për pikat te cilat sipas dispozitave te nenit 59 dhe 72 te LPP-se kane mundur te plotësohen me dokumente valide.
Po ashtu gjate këtij vlerësimi është eliminuar edhe OE ankues "**Nabs SHPK & Detas D.o.o**" i cili bashkangjitur ofertës i ka poseduar referencat për projekte te natyrës se ngjashme.
AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së kur ka eliminuar si te pa përgjegjshëm dy operatoret ekonomik ankues. Si rrjedhoje e kësaj procedure rezulton qe AK ka bere anulimin e aktivitetit ne kundërshtim me dispozitat e neni 62 te LPP-se.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorëve ekonomik ankues të **aprovohen** si të **bazuara**.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që ta beje **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit" me nr. prok. 622-20-2058-211**, në përputhje me dispozitat e LPP-së

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prizrenit.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Multi business Group".
- OE ankues - "Nabs SHPK & Detas D.o.o"